

**VENDIM**  
**Nr.958, datë 6.5.2009**

**PËR MIRATIMIN E KATEGORIVE TË LICENCAVE DHE TË PROCEDURAVE TË  
APLIKIMIT PËR LICENCË, TË PERSONAVE, FIZIKË DHE JURIDIKË, QË  
USHTROJNË VEPRIMTARI NË SISTEMET E FURNIZIMIT ME UJË DHE TË  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10081, datë 23.202009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kategorive të licencave për personat fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë apo do të ushtrojnë veprimtari në menaxhimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura si më poshtë vijon:

- a) Kategoria A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategoria B për përpunimin e ujit për konsum publik
- c) Kategoria C për largimin e ujërave të ndotura;
- ç) Kategoria D për përpunimin e ujërave të ndotura.

2. Personat fizikë apo juridikë, për t’u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura duhet të dorëzojnë, pranë ERRU-së, dokumentet e mëposhtme:

- a) Kërkesën me shkrim për aplikim për licencë, sipas formës së kërkuar nga ERRU-ja;
- b) Dokumentin e regjistrimit ligjor të operatorit, si person fizik apo juridik, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- c) Autorizimin nga pronari për drejtuesin ligjor, i cili jep të drejtën për të kryer të gjitha veprimtaritë për aplikimin dhe përdorimin e licencës përkatëse;
- ç) Dokumentin e regjistrimit në organet tatimore të zonës administrative, ku kërkohet të kryhet shërbimi;
- d) Lejen higjieno-sanitare nga Inspektori Sanitar Shtetëror i zonës administrative, ku kërkohet të kryhet shërbimi;
- dh) CV-në e drejtuesit ligjor dhe teknik;
- e) Lejen e mjedisit, kur kërkohet licencë për përpunimin e ujërave të ndotura;
- ë) Dokumentet e kualifikimit të drejtuesit teknik, si më poshtë vijon:
  - i) Për sistemet e furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura, drejtuesi teknik duhet të ketë diplomë universitare, në degët inxhinieri hidroteknike, ndërtim, inxhinieri elektrike, mekanike, mjedis apo disiplina të ngjashme, si dhe një përvojë pune mbi 5 vjet në këtë sektor;
  - ii) Në rastet kur operatori do të ushtrojë veprimtari për përpunimin e ujërave për konsum publik apo për përpunimin e ujërave të ndotura, ai duhet të ketë edhe një drejtues teknik të kualifikuar, me diplomë universitare në degët inxhinieri hidroteknike, të mjedisit, inxhinieri elektrike a në disiplina të tjera, të ngjashme;
- f) Dëshminë e penaltetit për drejtuesin, ligjor dhe teknik;
- g) Deklaratën me shkrim të drejtuesit ligjor dhe atij teknik, ku të deklarojë me përgjegjësi zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të nxjerra nga ERRU-ja, të standardeve shqiptare për veprimin dhe mirëmbajtjen e sistemit e të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Procesi i sigurimit të dokumentacionit të mësipërm nga ERRU-ja zgjat jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e aplikimit për licencë nga subjekti përkatës.

3. Ngarkohet Komisioni Kombëtar i ERRU-së për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Vendimi nr.400, datë 19.8.1999 i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**